



VENDIM

Nr. 141 Datë 26.12.2014

PËR

**PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR SHËRBIMET NDIHMËSE TË
KESH SH.A. PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.2 të *Modeli i Tregut* miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr 338, Datë 19.03.2008 i ndryshuar, neneve 20 dhe 21 të *Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s*, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Vendimit nr. 77, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”; Nenit 2.8 pika iii e “Rregullat e tregut Shqiptar të energjisë elektrike” miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr. 68, Date 23.06.2008, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.12.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës për shërbimet ndihmëse të KESH sh.a. për vitin 2015 dhe relacionin e Drejtorise së Tarifave dhe Çmimeve,

Vendosi :

1. Tarifa për shërbimet ndihmëse për vitin 2015 e KESH sh.a do të jetë:

158 leke /MWh

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.01.2015

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI